




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIK OF
KOSOVO GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË
VUSHTRRI / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U VUČITRNU
MUNICIPAL MINOR OF FENCES COURT IN VUSHTRRI



Nr.regj. 6569/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VUSHTRRI, gjyqtari duke e vendosur ne procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Idriz Muzaqit nga Vushtrria, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1 pika 1.1 Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtareve të lartë publik, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 26.04.2012 bjen kete:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Idriz Imer Muzaqi i lindur me dt. 09.02.1962 në Kurillove tani banon ne Vushtrri rr “Jeton Terstena”, jurist, i martuar, gjendjen ekonomike mesatare jo i denuar.

ESHTË PËRGJEGJËS

Sepse i pandehuri Idriz Muzaqi si zyrtar i lartë publik i komunes se Vushtrris, ka qene i obliguar sipas ligjit, qe deri me 31 mars 2011 te beje deklarimin e pasurisë se vet dhe ta njoftoi Agjencine kunder korrupsionit ne Prishtine, mirepo kete nuk e ka bere deri ne afatin e cekur me larte.

me cka ka bërë kundërvajtje mos deklarimi i pasurisë nga neni 16 paragrafi 1 pika 1.1 Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve ste lartë publik dhe per kete:

DENOHET

Me gjobë në shum prej 300 /treqinde/ € të cilin gjobë i pandehuri ka për të pague në afatin prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në favor të KGJK, nëse gjobën e shqiptuar nuk e pagan në afatin prej 15 ditësh e njejta konformë nenit 5 të LMK-ës do t’i zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh duke llogaritur nga 15 € për një ditë burge.

Konformë nenit 109 al. 2 të LMK-ës i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 € në afat të njejt me gjobën.


Nga një kopje të këtij aktvendimi të iu dërgohet të pandehurit dhe parashtresit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia kunder korrupsionit ne Prishtine ka parashtre kërkesën nr. 01-3204/11 dt. 20.07.2011 për iniciimin e procedures kundërvajtëse ndaj të pandehurit Idriz Muzaqit nga Vushtrria, për kundërvajtje e cekur me larte.

I pandehuri me Aktvendimin me nr. 6569/11 te dates 05.03.2012 eshte gjobite me 300 € per kundervajtje mos deklarimi i pasurisë dhe i njejt ne afatin ligjor ka parashtuar ankese te cilen ankese e ka shqyrtar Gjykata e larte Per Kundervajtje ne Prishtine, dhe e ka aprovuar si te bazuar, ashtuqe aktvendimin e goditur e ka prish dhe lenden e ka krye ne rishqyrtim dhe rivendosje duke propozuar qe te mirret ne pyetje edhe ushtruesi i kerkeses, ne rivendosje gjyqtari ka vepruar sipas udhezimeve te Gjykates se Larte duke bere plotesimin gjegjesisht duke e marre ne pyetje ushtruesin e kerkeses.

I pandehuri ne mbrosjtjen e tij te dhanun ka deklaruar se une jam drejtor i Drejtoris per Administrate ne Kuvendin Komunal ne Vushtrri, por jo edhe per personel sepse kete te dyten e kryen nje puntor tjetër kurse nga Agjencia kunder Korrupsionit me ka ardhe formulari per deklarimin e pasurisë me qe une ate nuk e kam permbushë sepse sipas mendimit tim nuk beje pjese ne kategorin e udheheqesve. Por qe kjo nuk duhet ta bejne deklarimin e pasurisë dhe kjo ka qene arsyeja qe une nuk kam veprue si kërkeses se tyre, dhe une tani ushtroi vetem postin e drejtorit te Drejtoris per Administrate.



03-17/2012/02
Aug.


Per vertetimin e drejte te gjendjes faktike eshte marre ne pyetje Perfaqesusi me autorizim i Agjencise kunder Korrupsionit nga Prishtine i cili deklaron: Agjencia kunder Korrupsionit mbetet pran kerkeses se ushtruar me heret kunder zyrtarit te larte Idriz Muzaqit i cili ne baze te listes se derguar nga komuna e Vushtrris me daten 03.03.2011 eshte zyrtar i larte public dhe ka pas per obligim deklarimin e pasurise deri me 31.03.2011 mirepo, zyrtari i larte public nuk e ka perbushe kete obligim ligjor andaj Agjencia kunder Korrupsionit e ka inicuar proceduren kundervajtjese kunder te pandehurit, kurse pohimi it e pandehurit i cili ka deklarue se nuk jam zyrtar public nuk qendron sepse sipas ligjit per deklarimin e pasurise i cili ka qene ne fuqi ne vitin 2011 ne nenin 3 paragrafi 1.1 thot se drejtori i administrates dhe i personelit te Kuvendit Komunal kane per obligim deklarimin e pasurise dhe parashihen ne listen e zyrtareve te larte public.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, marrjes në pyetje të pandehurit, deklarates te perfaqesusit te ushtruesit te kerkeses, gjyqtari në mënyrë të plotë dhe të drejtë e vërtetoi gjendjen faktike se i pandehuri e ka kryer kundervajtje me te cilen ngarkohet, sepse i njeiti eshte vertetue qe ka qene zyrtar i larte public ne komunen e Vushtrris dhe nuk e ka bere deklarimin e pasurise ashtu siqe parashihet me ligje dhe kete e ka vertetue ne menyre te plote gjat deklarimit perfaqesusi i autorizuar i Agjencionit kunder Korrupsion andaj faktet e parashtruara nga i pandehuri i cili deklaron se nuk jam zyrtar ilarte kpublik nuk qendrojne. Dhe ne baze te cekurave me larte gjykta konstatoi se i pandehuri e ka kryer kundervajtjen mos deklarim i pasurise per cka të njeitin e shpalli përgjegjës dhe e denoi me gjobën e cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit gjyqari i vlersoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-s dhe të pandehurit ja shqiptoi këtë denim duke llogarit se edhe me këtë denim do të arrihet efekti i denimit ndaj të pandehurit që i njeiti në të ardhmen të mos kryej kundervajtje të këtilla apo të ngjajshme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VUSHTRRIS
dt. 26.06.2012



KSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të parashtror i pandehuri dhe ushtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.